


Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Nëntor 2017

Tiranë, më 11 Dhjetor 2017: Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Nëntor 2017, arriti 103,0 kundrejt muajit Dhjetor 2015.

Në muajin Nëntor 2017 ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit është 1,7 %. Një vit më parë ky ndryshim ishte 1,9 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)




Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit.

Rritja vjetore e çmimeve në muajin Nëntor është ndikuar kryesisht nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +1,39 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” dhe “Transporti” kanë kontribuar me +0,12 pikë përqindje secili. Çmimet e grupit “Pije alkoolike dhe duhan” kanë kontribuar me +0,04 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Argëtim e kulturë” kanë kontribuar me +0,02 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Shërbimi arsimor” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” kanë kontribuar me +0,01 pikë përqindje secili. Çmimet e grupeve “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje shtëpie” dhe “Veshje dhe këpucë” kanë kontribuar respektivisht me -0,03 dhe -0,02 pikë përqindje.

Për publikim 11/12/2017

Fig.2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Nëntor 2016, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 3,7 %, pasuar nga grupet “Transporti” me 1,9 %, “Pije alkoolike dhe duhan” me 0,9 %, “Argëtim dhe kulturë” me 0,8 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 0,6 %, “Shërbimi arsimor” me 0,5 %, “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0,3 %, “Hotele, kafene dhe restorante” me 0,2 %. Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “fruta” u rritën me 20,8 %, pasuar nga nëngrupet “zarzavate përfshirë patatet” me 11,0 %, “peshk” me 4,4 %, “mish” me 1,9 %, etj. Nga ana tjetër çmimet e nëngrupit “vajra dhe yndyrna” u ulën me 3,3 %, pasuar nga “sheqer, reçelna e ëmbëlsira” me 3,1 %, etj..

Ndryshimi mujor i indeksit është -0,1 %. Krahasuar me muajin Tetor 2017 ulja më e madhe e çmimeve vërehet në grupet “Argëtim dhe kulturë” me 1,5 %, pasuar nga “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 0,8 %. Rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupet “Transporti” me 1,3 %, pasuar nga “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” dhe “Shëndeti” me 0,4 % secili.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2015=100

Kodi	Grupet	Peshat	11-16	12-16	01-17	02-17	03-17	04-17	05-17	06-17	07-17	08-17	09-17	10-17	11-17
Gjithsej		100,0	101,3	102,2	103,7	104,3	104,7	104,0	102,8	102,4	102,3	102,7	103,1	103,1	103,0
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	40,0	101,9	104,6	108,5	110,1	110,6	109,1	106,2	105,5	105,1	106,2	106,7	106,5	105,7
2	Pije alkoolike dhe duhan	4,4	100,9	101,3	101,4	101,4	101,7	101,9	101,7	101,7	101,6	101,6	101,6	101,5	101,7
3	Veshje dhe këpucë	4,0	100,6	100,9	99,9	97,6	97,7	96,0	96,4	95,8	96,4	96,0	98,3	99,9	100,2
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	20,7	101,5	100,9	101,1	101,3	101,8	101,5	101,4	101,4	101,4	101,4	101,5	101,6	102,0
5	Mobillje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	6,5	100,2	100,2	100,3	100,1	99,9	99,9	99,9	99,8	99,4	99,5	99,4	99,5	99,7
6	Shëndeti	3,0	100,2	100,2	100,3	100,3	100,2	100,1	100,2	100,1	100,1	100,0	100,0	100,0	100,4
7	Transporti	6,2	99,5	99,2	99,4	98,9	99,9	100,4	99,7	99,3	99,7	100,2	100,3	100,0	101,3
8	Komunikimi	2,5	100,7	100,6	100,2	100,2	100,2	100,5	100,5	100,5	100,5	100,5	100,4	100,4	100,7
9	Argëtim dhe kulturë	2,6	100,9	102,3	103,3	103,0	103,3	104,7	102,2	101,5	100,6	100,3	102,5	103,3	101,8
10	Shërbimi arsimor	2,5	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7	100,9	101,3	101,3
11	Hotele, kafene dhe restorante	2,9	100,0	100,1	100,1	100,2	100,2	100,2	100,2	100,1	100,1	100,1	100,1	100,1	100,2
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	4,7	103,1	103,3	103,2	103,2	103,5	103,3	103,3	103,4	103,4	103,4	103,4	103,4	103,4

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	11-16/11-15	12-16/12-15	01-17/01-16	02-17/02-16	03-17/03-16	04-17/04-16	05-17/05-16	06-17/06-16	07-17/07-16	08-17/08-16	09-17/09-16	10-17/10-16	11-17/11-16
Gjithsej		1,9	2,2	2,8	2,2	2,1	1,9	2,0	2,2	2,0	1,6	1,6	1,9	1,7
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	3,2	4,6	5,8	3,9	3,3	3,0	3,8	5,1	4,7	3,3	3,5	4,0	3,7
2	Pije alkoolike dhe duhan	1,5	1,3	0,9	0,6	0,5	1,0	0,8	0,8	0,7	0,7	0,6	0,4	0,9
3	Veshje dhe këpucë	0,8	0,9	0,6	-0,4	-0,7	-2,3	-2,1	-2,5	-1,7	-2,1	-1,6	-0,4	-0,4
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	1,5	0,9	0,4	0,6	1,1	0,9	0,9	0,9	1,1	1,1	1,1	1,1	0,6
5	Mobillje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,7	0,2	-0,1	-0,2	-0,1	-0,3	-0,4	-0,5	-1,1	-0,9	-0,8	-0,2	-0,5
6	Shëndeti	0,2	0,2	0,2	0,2	0,1	-0,1	0,2	-0,1	0,0	0,1	-0,2	0,0	0,2
7	Transporti	-0,5	-0,8	2,8	3,2	3,8	4,3	2,6	0,7	0,4	0,4	0,8	0,4	1,9
8	Komunikimi	0,7	0,6	0,2	0,2	-0,1	0,6	0,6	0,5	0,6	0,6	-0,1	0,0	0,0
9	Argëtim dhe kulturë	0,8	2,3	3,1	2,8	3,2	4,5	2,0	0,6	-1,1	-1,1	0,8	2,1	0,8
10	Shërbimi arsimor	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	1,0	0,9	0,5
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,1	0,1	0,1	0,2	0,2	0,1	0,1	0,0	0,0	0,0	0,1	0,0	0,2
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	2,7	3,3	3,2	3,0	3,4	3,1	3,0	3,2	3,4	3,0	0,1	0,2	0,3

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	11-16	12-16	01-17	02-17	03-17	04-17	05-17	06-17	07-17	08-17	09-17	10-17	11-17
	Gjithsej	0,1	0,9	1,5	0,5	0,4	-0,6	-1,2	-0,3	-0,1	0,4	0,4	0,04	-0,1
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	-0,5	2,7	3,7	1,5	0,5	-1,4	-2,7	-0,7	-0,3	1,0	0,5	-0,1	-0,8
2	Pije alkoolike dhe duhan	-0,3	0,4	0,1	0,0	0,3	0,2	-0,2	0,1	-0,1	0,0	0,0	0,0	0,2
3	Veshje dhe këpucë	0,3	0,3	-1,0	-2,3	0,1	-1,7	0,3	-0,5	0,6	-0,4	2,4	1,6	0,3
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	1,0	-0,6	0,2	0,2	0,5	-0,3	-0,1	0,0	0,0	0,0	0,1	0,1	0,4
5	Mobililje, paisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,6	0,0	0,1	-0,1	-0,2	0,0	0,0	-0,1	-0,4	0,1	-0,1	0,1	0,2
6	Shëndeti	0,3	-0,1	0,1	0,0	0,0	-0,1	0,1	-0,1	0,0	-0,1	-0,1	0,0	0,4
7	Transporti	-0,1	-0,3	0,2	-0,5	1,0	0,5	-0,7	-0,4	0,4	0,5	0,1	-0,3	1,3
8	Komunikimi	0,2	0,0	-0,4	0,0	0,0	0,3	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,2
9	Argëtim dhe kulturë	-0,3	1,4	0,9	-0,3	0,4	1,3	-2,4	-0,7	-0,9	-0,3	2,2	0,8	-1,5
10	Shërbimi arsimor	0,3	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,2	0,3	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	-0,1	0,0	0,0	0,1	0,0	0,0	0,0	-0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	-0,1	0,2	0,0	-0,1	0,3	-0,2	0,0	0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0

Shpjegime metodologjike

- Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjise ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2015.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Kjo listë është përditësuar në 332 mallra dhe shërbime nga 333 që ishte vitin e kaluar.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mbliidhen çmimet.

- Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri. Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve. IÇK në vitin t llogaritet me strukturën e shpenzimeve të vitit $(t-1)$.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.